

REPARATUR MALTER – F4

Suva çimento-polimerike për riparim të prerjeve me trashësi 1,0-2.0 cm, me kompensim të tkurrjes, i bërë me armaturë me PP-fije Përgjigjet në EN 1504-3 Klasi R4

Fusha e aplikimit:

Reparatur malter – F4 përdoret për riparime konstruktuese të elementeve të betonit dhe të betonit me armaturë, për rritje të shtresës mbrojtëse të armaturës, për sanim të vendeve të dëmtuara dhe të segreguara e të tjera.

Cilësi:

- adezion i shkëlqyer për nënshtresën e betonit;
- karakteristika të larta të fortësisë;
- performansa të shkëlqyera nga aspekti i kohëgjatësisë;
- i thjeshtë për përgatitje dhe realizim;
- nuk janë të nevojshme vegla speciale për vendosje;
- rezistent në ndikesa atmosferike;
- mbron nga karbonizimi
- nuk përmban kloride

Karakteristika teknike:

Cilësi	Metodë	Vlerë e deklaruar
Dukje	-	Masë e përhitur në formë pluhuri
Faktor ujë/material	-	C2ES1
W/M faktor ujë/material	-	0.15-0.16
Madhësia maksimale e mbushësit	-	4. mm
Masë volumi	EN 12190	(2100 ÷ 2300) kg/m ³
Koha e fortësimit	EN 13294	
-fillimi		(3 ÷ 5) h
-fondi		(5 ÷ 7) h
Fortësi në presion	EN 12190	
-pas 7 ditë		≥ 35 Mpa
-pas 28 ditë		≥ 8 MPa

Metodologji e realizimit:

Përgatitje e nënshtresës:

Nënshtresa në të cilat vendoset Reparatur malter – F4 duhet të jetë e pastër, të mënjanohe të gjitha pjesët labile, e pastruar nga pluhuri, pa yndyrëra dhe e ngopur me ujë. Temperatura e sipërfaqes në të cilën vendoset materiali duhet të jetë në kufijtë prej 5°C deri 30°C.

Gjatë sanimit të elementeve të vjetra të dëmtuara të betonit me armaturë, armatura e dukshme dhe ankerët duhet të pastrohen nga korozioni (me furçë çeliku ose me fërkim me rërë). Me qëllim të realizimit të adezionit më të mirë me nënshtresën, si dhe për stabilizim sipërfaqësor të të njëjtës, para vetë vendosjes së Reparatur

Malter – F4, nënshtresa e betonit rekomandojmë të pajmerohet me Reparatur penetruat ose prajmer të përgatitur me përdorimin e Vrska-U.

Vendosje:

Përzjerja nga Reparatur malter – F4 përgatitet me shtimin e ujit, në raport të peshës prej 150 deri 160 g për 1 kg material (në një thes prej 25 kg material janë të nevojshme 3,75 deri 4,0 kg ujë). Përzihet me mikser të ngadalshëm deri në homogjenizimin e plotë – më së paku 3 minuta.

Përzjerja lihet të rri deri 5 minuta, e mandej përzihet sërish, Vendosja bëhet me shpahëll, mistri ose glet-vegël metali. Trashësia maksimale e shtresës në një procedurë është 2,0 cm.

Disa orët e para pas vendosjes duhet të mbrohet nga tharje tejet e shpejtë me aplikimin e metodave përkatëse për kultivimin e suvasë – të pengohet ekspozimi në temperatura të larta (mbi 30°C), si dhe nga ekspozimi i drejtpërdrejtë në diell dhe erë.

Për të arritur adezion më të mirë dhe mbrojtje të armaturës së ekspozuar, para së Reparatur malter F-4, në sipërfaqen e përgatitur vendoset paralyerje Reparatur penetruat me furçë ose me spërkatje. Vendosja e materialit bëhet në periudhë prej 30 deri 120 minuta pas vendosjes së paralyerjes.

Pastrimi:

Veglat dhe pajisja, menjëherë pas përdorimit pastrohen me ujë.

Vendosja në depo:

Në ambalazh të mbyllur original. Në hapësira të thata, në temperaturë prej 5°C deri 35°C. Afati i përdorimit 12 muaj.

Paketimi:

Në natron thasë prej 5 kg
Në ventil thasë prej 25 kg

Rezik për jetën: Nevojitet që të shmanget kontakti i prodhimit me lëkurën (të përdoren doreza mbrojtëse). Materiali nuk është toksik, por gjatë kontaktit incidental, në tast të kontaminimit të pjesëve të lëkurës, vendet e njëjta duhet menjëherë të lahen me ujë dhe sapun. Nëse materiali spërkat në sy, nevojitet që ato menjëherë të shpëlahen me shumë ujë dhe të kërkohet ndihmë mjekësore.

Zjarr: Reparatur malter F4 nuk mund të ndizet.

Pastrimi dhe vendosja në depo: Pastrimi bëhet me ujë. Ambalazhi i vjetër i përdorur duhet të deponohet sipas dispozitave dhe rregullativave lokale për atë lloj të mbetjeve.